

VENDIM
Nr. 139, datë 26.12.2014

PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE
NGA KESH SHA PËR VITIN 2015

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 20 dhe 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, vendimit nr. 77, datë 26.6.2008, “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për kompaninë publike të gjenerimit të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë(ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.12.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e KESH sh.a. për përcaktimin e tarifës për prodhimin e energjisë elektrike për vitin 2015 dhe relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve,

VENDOSI:

1. Tarifa e prodhimit të energjisë elektrike nga KESH sh.a. për vitin 2015, do të jetë 1.45 lekë/kWh.
 2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e KESH sh.a.
- Ky vendim hyn në fuqi në datën 1.1.2015.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti